URDHËR
Nr. 112, datë 19.4.2019

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 12, pikat 1 dhe 13, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 7, pika 3 e rregullores "Për veprimtaritë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, në mungesë të Kryetarit të Kolegjit

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Luan Daci, si vijon:
a) përgatit, thërret e drejton mbledhjen e anëtarëve;
b) përfaqëson Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në marrëdhënie me të tretët;
c) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Kolegjit;
d) nënshkruan akte të tjera të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me përjashtim të vendimeve;
e) drejton shortin në rastet e përcaktuara në nenet 14, 15, 18, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.
2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është për periudhën 23 prill 2019 deri më 25 prill 2019.
3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Luan Daci.
4. Z. Luan Daci mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Natasha Mulaj